



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 9802 / Prot.

Tiranë, më 11 . 12 . 2018

Nr. Identifikimi 950

Vendimi 57

### DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440”, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

#### VENDOSI :

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Person juridik:** “GJOKA KONSTRUKSION” sh.a.  
**Nr. NIPT-i:** J91815014U  
**Adresa e selisë:** Rruga “Dora D’Istria”, hyrja 1 dhe hyrja 2, Pasuria me nr.7/637+1-N2, 7/637+1-N5, 7/637+2-N1, Z.K.8270, Njësia Nr.5, Tiranë  
**Personi përgjegjës:** Rrok Gjoka

Për të zhvilluar projektin: “**Përmirësimi, ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e rrugës së Arbrit**”

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar, Shtojca I, 7. ç) Ndërtimi i një rruge të re me katër ose me shumë korsi, ose rregullimi dhe / ose zgjerimi i një rruge ekzistuese, që ka dy apo me pak korsi, në mënyrë që të bëhet me katër ose me shumë korsi, kur rruga e re ose seksioni i rregulluar dhe / ose i zgjeruar i saj do të jetë 10 kilometra ose me shumë në gjatësi të vazhdueshme.

**Vendndodhja:** Tiranë - Shkalla e Tiranës (ose Tujanit) - Qaf Murrizë - Guri i Bardhë - Ura e Vashës (Klos) - Plan i Bardhë - Bulqizë - Shupenzë - Dibër

**Gjatësia totale e rrugës së Arbrit:** 73 km

*(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:



**Miratimin e lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

**1. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**

Zhvillimi i këtij aktiviteti zhvillohet në bazë të:

Kontratës Koncesionit nga MEI me Nr. 553 Rep. Nr. 247 Kol, datë: 16.03.2018, dhe Shoqërisë “Gjoka Konstruktion” sh.a. për “Përmirësimin, Ndërtimin, Operimin dhe Mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit”

**2. Mendimi i institucioneve të konsultuara:**

*Drejtoritë teknike të Ministrisë së Mjedisit shprehin mendimin si më poshtë:*

- Në raportin e VNM-së të plotësohet informacioni në drejtim të kërkesave të legjislacionit si më poshtë vijon:
  - ✓ Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar;
  - ✓ Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
  - ✓ Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23. 04. 2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme;
  - ✓ Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 ”Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme;
- Subjekti që do të transportojë apo transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licencë të tipit III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar.

Të jepet informacion më i zgjeruar në raport në drejtim të:

- ✓ sasisë së gjenerimit të mbetjeve,
- ✓ trajtimit të mbetjeve,
- ✓ transportimit të mbetjeve dhe
- ✓ asgjësimit të mbetjeve, sipas kërkesave ligjore të sipërcituar dhe akteve të tjera në fuqi

**Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet:**

- Subjekti “Gjoka Konstruktion” sh.p.k, kërkon të zhvillojë aktivitetin “Përmirësim, ndërtim, operim dhe mirëmbajtja e Rrugës së Arbrit 73 Km”, me vendodhje bashkia Tiranë.
- Sipas dokumentacionit dërguar nga ju, si dhe projekt - zbatimit të kësaj rruge, rezulton se sipërfaqja e kërkuar (zona) shtrihet në zonën e mbrojtur të Parkut Kombëtar “Mali i Dajtit”, shpallur me VKM-në Nr. 402, datë 21.06.2006 (me sipërfaqe të zgjeruar), kategoria II.
- Meqënëse kryerja e këtij investimi ka një rëndësi të madhe në zhvillimin e infrastrukturës rrugore dhe është një vepër me rëndësi kombëtare, kërkojmë nga subjekti “Gjoka





- Konstruksion” shmangien e kësaj vepre nga zona qendrore e parkut, shmangien e lëvizjes së mjeteve jashtë rrugëve të përcaktuara, me qëllim minimizimin e impakteve negative në mjedis.
- Gjatë kryerjes së punimeve në terren kërkojmë nga subjekti që të respektojë kushtet dhe kriteret e lejes mjedisore. Subjekti gjatë punimeve të bashkëpunojë për minimizimin e impaktit në mjedis me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura, (AdZM Tiranë), pasi është kjo administratë që monitoron dhe menaxhon territorin e parkut.

*Drejtoria Rajonale e Mjedisit Dibër:* Shprehet pozitivisht për zhvillimin e aktivitetit.

*Drejtoria Rajonale e Mjedisit Tiranë:* Shprehet pozitivisht për zhvillimin e aktivitetit.

- **Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun**

*Konsultimi me publikun:* Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoritë Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitorëve iu siguria të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

3. **Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:**
  - 3.1 Ky vendim është i vlefshëm, nëse ndërtimi i objektit është në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore në fuqi.
  - 3.2 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tilla si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
  - 3.3 Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të ketë marrë miratim nga institucionet kompetente.
  - 3.4 Subjekti duhet të tregoj kujdes të veçantë për menaxhimin e mbetjeve inerte si dhe ujërave të ndotura sipërfaqësor duke mos i hedhur ato në lumë.
  - 3.5 Të kryhen punime vetëm në gjurmët e projektit të propozuar.
  - 3.6 Masa e dheut e gjeneruar nga operacionet e gjurmimit, të sistemohet në një vend të caktuar dhe të ruhet për qëllimin e rehabilitimit.
  - 3.7 Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
  - 3.8 Për asnjë arsye mos të ketë prerje pemësh në zonën ku do të zhvillohet projekti.
  - 3.9 Të mbillen pemë në ambientet e projektit të propozuar.
  - 3.10 AKM sugjeron mbellje të bimëve autoktone në zonë.
  - 3.11 Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët,
  - 3.12 Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pautorizuara.



- 3.13 Gjatë fazës së rikonstruksionit të mbahet nën kontroll ndotja e ajrit, brenda standarteve të OBSH-së;
- 3.14 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit të çaktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte
- 3.15 Për asnjë arsye mos të ketë hedhje të mbetjeve inerte pranë burimeve ujore.
- 3.16 Vendorsja e ndriçimit gjatë rrugës të bëhet në bashkëpunim me organet kompetente të energjisë elektrike.
- 3.17 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 3.18 Kompania të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 3.19 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 3.20 Në raste aksidentesh ose defektesh që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 3.21 Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipërcituara në Vendim.
- 3.22 Kompania duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura në raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- 3.23 Në rast se gjatë fazës së ndërtimit, aktiviteti prek në zona të rëndësishme të veçantë, subjekti duhet të zbatojë kërkesat sipas Ligjit Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura" si dhe të vërë në dijeni, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura si, autoritetin përkatës i cili ka për qëllim menaxhimin, mbrojtjen, zhvillimin, zgjerimin dhe funksionimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura në vendin tonë, si dhe menaxhon rrjetin e zonave të mbrojtura dhe rrjetet e tjera natyrore si Natura2000, sipas planeve të menaxhimit të hartuara.
- 3.24 **Në përfundim të punimeve, të sillt pranë AKM një raport mbi gjendjen e mjedisit të shoqëruar me foto dhe mbi punimet rehabilituese gjatë gjithë vijës së projektit.**  
*Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 "Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së", ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.*

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM**

**EDISON KONOMI**



**MINISTRI**  
**BLENDI KLOSI**



